

Ne bazë të nenit 34 dhe nenit 20 të Ligjit për menaxhim me prone të konfiskuar, shfrytëzim të pronës dhe mjete të konfiskuara ne procedure penale dhe kundërvajtjeje („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, nr.98/08,145/10,104/13,187/13, 43/14,160/14 dhe 97/15),ndërsa në lidhje me nenin 28 dhe nenin 30 te Regullores për veprim me pronë të konfiskuar(„Gazeta Zyrtare e Republikës se Maqedonisë nr.115/13 dhe 141/14), ndërsa në pajtim me Vendimin e sjellë për fillimin e procedurës për shitje të mjeteve të tundshem të konfiskuara nr.02-3961/2 të datës 01.09.2015, të sjellë nga Këshilli Drejtues, Agjencia për menaxhim me prone të konfiskuar e publikon:

SHPALLJE nr.4

Për shitjen e mjeteve të tundshme të konfiskuara – makina ngarkuese përmes ankandit publik elektronik

I. DIZPOZITA E PËRGJITHSHME

1. Shitësi i mjeteve të tundshme – makina ngarkuese është AGJENCIA PËR MENAXHIM ME PRONËN E KONFISKUAR me seli në rr. Makedonija pn 1000 Shkup

Nr.Re	Përshkrimi dhe lloji i makinës.	Lloji/modeli	Viti i prodhimit	Numri i shasisë	Fuqia e motorit në Kw	Vëllimi i motorit.
1.	Tmv-cisternë VOLVO	FH62RB /A4CFC9	2003	YV2A4CFC93B337907	309	12130
2.	Tmv-cisternë Mercedes Benz	ATEGO 1823	2003	WDB9505321K829150	170	6374
3.	Tmv-cisternë VOLVO	FH126X2 R420	2005	V2AN60C46B420768	309	12130
4.	Tmv-tërheqës VOLVO	FH42TB FH124X2 TB420.3	2005	YV2AN60A16B420614	309	12130
5.	Gjysmë rimorkio Cisternë UTVA	PP 33 A3	1992	11814	/	/

II. LËNDË E SHITJES

1.Lëndë e shitjes janë makinat ngarkuese ne vijim të cilat shiten së bashku me përshkrimin në vijim:

2.Vlera e makinave ngarkuese të konfiskuara për të gjitha së bashku është 2.440.800,00 pa TVSH të përfshirë në pajtim me vlerësimin nr.CB V 185/15 te dates 25.08.2015 të Ministrisë së drejtësisë –Byroja për ekspertiza ligjore .

III. CMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

1. Cmimi fillestar për shitjen e makinave ngarkuese përmes ankandit publik elektronik për të gjitha së bashku është 2.440.800,00 denarë në pajtim me vlerësimin nr.CB V 185/15 te datës 25.08.2015 te Ministrisë së drejtësisë –Byroja për ekspertiza ligjore .

2.Mënyra e pagesës : Blerësi është i obliguar që cmimin ta paguajë menjëher me pagesat e llogaritura TVSH dhe te marrë makinat menjëherë pase përfundimit të ankandit publik.

3. Të gjitha shpenzimet në lidhje me marjen e automjeteve nga vendet e Agjencisë për menaxhim me pronë të konfiskuar bien ne barrë të blerësit .

IV. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE

1. Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kane te gjitha subjektet e interesuara juridike dhe fizike te vendit dhe të huaj të cilat mund të kene të drejten te posedojn pronë të tundshme në teritorin e R.Maqedonisë ne pajtim me Ligjin dhe te cilet I plotsojn kushtet nga Shpallja,pervec subjektit te denuare ose subjektit kundër të cilit është ngritur procedure penale ose për kundërvajtje,të punësuarite në Agjencinë per menaxhim me pronë të konfiskuar,si dhe subjekt tjetër I cili në mënyrë zyrtare ka marrë pjesë në procedure për shitje.

2. Subjektet e interesuara juridike parashtrojn fletëparaqitje me dokumentacion te nevojshem per pjesëmarrje ne ankandin publik. Fletëparaqitja për pjesëmarrje në ankandin publik së bashku me fletëpagesën si vërtetim për garanci të paguar për pjesëmarrje dhe dokumentacioni i nevojshëm të dorëzohet përmes Arkivit të Agjencisë për menaxhim me pronë të konfiskuar, për cka paraprakisht është i nevojshëm regjistrimi elektronik në linkun në vijim <http://odzemenimot.gov.mk/razno/registracija.aspx> dhe fletëparaqitjes elektronike për lëndën për të cilin bëhet ankandi. (Fletëpraqitja mund të merret në arkivin e Agjencisë për menaxhim me pronë të konfiskuar ose të merret nga ueb faqja www.odzemenimot.gov.mk).

3. Me fletëparaqitjen për pjesëmarrje në ankandin publik duhet te dorëzohet edhe dokumentacioni në vijim

3.1 Dëshmi për depozitë të paguar (original ose kopje të vërtetuarë në noter)

3.2 Dëshmi për identitet

-letërnjoftim ose document udhëtimi per subjektin fizik

-gjendje aktuale nga Regjistri qendror I RM për subjektet juridike të vendit

-certifikatë nga regjistrimi nga regjistri perkatës për subjektet juridike të huaja.

V. KUSHTET E PERGJITHSHME

1. Makinat te cilat janë lend e shitjes gjenden ne oborrin në Idrizovë të Agjencise per menaxhim me pronate konfiskuar dhe shikimi I tyre do të bëhet me datën 09.09.2015 dhe 10.09.2015 prej ora 10:00 deri në ora 14:00. Shitja e makinave behet duke I pare paraprakisht , sipsas parimit „e parë-e blerë,,.
 2. Shitja do të bëhet përmes ankandit publik elektronik përmes sistemit të ankandit publik elektronik Agjencia për menaxhim me pronë të konfiskuar www.odzemenimot.gov.mk.
 3. Publikimi i kësaj shpallje zgjat 10 (dhjetë) ditë duke filluar prej 05.09.2015 deri më 14.09.2015.
 4. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankandin publik është 14.09.2015
 5. Ankandi publik do të fillojë me datë 21.09.2015 ne ora 11 dhe do të zgjasë 15 min. deri ne ora 11.15
 6. Subjektet juridike te interesuara për blerje të makinave do të mund të marrin pjesë në ankandin publik elektronik nëse paguajnë garanci me shumë prej 10% të vlerës së përcaktuar e makinave 2.440.800,00 denarë) në llogarine buxhetore 10000000063095 pranw BPRM nënlllogaria (llogaria shfrytëzuesit buxhetorë) 040136140969619, shifra hyrëse 722115 programi 20.
 7. Garancija e cila duhet te paguhet eshte gjithsej 244.080,00 denare.
 8. Ofertuesve oferta e të cilëve nuk është pranuar, garancioni u kthehet menjëherë pas përfundimit të ankandit publik.
 9. Ankandi publik nuk do të bëhet nëse paraqitet vetëm një ofertues.
 10. Kushtet për shitje dhe procedurë për mënyrën e ankandit mund të shihen në <http://odzemenimot.gov.mk/razno/registracija.aspx> në pjesën Udhëzime për licitacion.
 11. Pas përfundimi të ankandit publik elektronik procesverbali për ecurinë e ankandit publik elektronik u dorëzohet të gjithë pjesëmarrësve të cilët kanë marrë pjesë në ankandin publik elektronik.
 12. Ofertuesi i cili do të arrijë cmimin më të lartë bëhet pronar i mjeteve dhe është i obliguar që cmimin ta paguajë menjëherë pas përfudimit të ankandit publik, në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë në llogarinë buxhetore 10000000063095 pranë MPRM, nënlllogaria (llogaria e shfrytëzuesit buxhetor) 040136140969619, shifra hyrëse 722115 programi 20. të ulur për garancinë e dorezuar.
- Nëse blerësi nuk paguan cmimin në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga përfundimi i anakndit publik do të llogaritet se blerësi ka hequr dorë nga lënda e shitjes dhe garancia e dhënë do të shfrytëzohet për manipulimin e harxhimeve të ankandit publik.

Informata në lidhje me shitjen, blerësit e interesuar mund te marrin ne telefonin 02 3209-920.